


Rubin Kadiu

## Frymëzuar nga Radioja

Papunësia apo bërja e një pune të papërshtatshme është fenomen shqetësues për shumë të rinj e të reja shqiptare në ditët e sotme. Sidoqoftë, informacioni i duhur në lidhje me vendet e lira të punës apo me mundësitë e tjera të të bërit biznes, e ndihmon këtë kategori punëkërkuesish të gjejnë punën e përshtatshme dhe jo në pak raste bëhet frymëzim edhe për të filluar një biznes të ri. Ky është edhe rasti i Rubin Kadiut, 33 vjeç, i cili në prill të vitit 2015 vendosi të investojë së bashku me vëllain e tij Alfredin, në hapjen e një dyqani produktesh elektronike në zemër të Tiranës. Të autorizuar për shitjen dhe riparimin e markave të ndryshme të produkteve

## Inspired by Radio

Being unemployed or stuck in an unsuitable job is a problem many young Albanians face nowadays. Accessing appropriate information about jobs and other business opportunities however can help young people find employment, or the inspiration to start a new business. This is the case of Rubin Kadiu, 33, who in April 2015 decided to invest together with his brother Alfred in opening up an electronic shop right in the heart of Tirana. They are authorized to sell and service different brands of electronic and digital products, attracting a lot of customers -mostly young people- who walk into their shop to not just to look or buy an electronic device but also to find out how the latest technologies

elektronike dhe dixhitale, vëllezërit Kadiu tërheqin një gamë të gjerë klientësh -kryesisht të rinj, të cilët e frekuentojnë dyqanin e tyre jo vetëm për të blerë një pajisje elektronike, por edhe për të mësuar mbi tendencat e fundit të teknologjisë.

Ajo çka e bën të veçantë historinë e tyre është burimi i frymëzimit për të filluar këtë biznes të ri: rubrika e përjavshme radiofonike "Të reja punësimi" në Club FM, mbështetur nga projekti RisiAlbania. **"Ka pasur shumë njerëz në emision që rrëfenin se si guxuan të hapnin biznesin e tyre. Dhe krejt papritur, ajo ishte bërë e pashmangshme edhe për ne. I ramë lapsit, dhe hapëm dyqanin tonë, në një nga sheshet më të populluar të Tiranës."**- thotë Rubini.

Biznesi i tyre ka qenë i qëndrueshëm deri më tani, ku Rubini merret kryesisht me produktet dhe shitjet, ndërsa i vëllai kujdeset më tepër për shërbimet që ofron dyqani. Brenda një viti ata ishin në gjendje të punësonin 4 vajza të reja, të cilat e duan teknologjinë dhe njëherësh kanë kënaqësi të komunikojnë me klientët. Marime Gjata është njëra prej tyre; për Marimen **"puna me teknologjinë është e bukur -është këndshëm të kesh në duar produktet e fjalës së fundit të teknikës, e të jesh e informuar në lidhje me produktet e reja që pritet të hyjnë në treg".**

Ndërsa marrëdhëniet mes njerëzve e teknologjisë shohin vetëm rritje, vëllezërit Kadiu e shohin dyqanin e tyre të orientuar më shumë drejt shërbimeve për zgjidhjen e problemeve që mund të hasin përdoruesit me pajisjet. Ata janë duke punuar për zhvillimin e një aplikacioni dhe të një

work.

What makes their story special is where they got the inspiration to start this new business: the weekly broadcast "Employment News" on Radio Club FM, which was supported by RisiAlbania project. **"There were a lot of people on the show who had taken the plunge and opened their own business. And all of a sudden, it had become unavoidable for us too. We did the math, and we could open our own store, in a busy square nonetheless."** - says Rubin.

Their business has been sustainable so far, with Rubin concentrated in products and sales while his brother runs the service wing of the shop. Within a year they were able to employ 4 young ladies, who love technology and love interacting with customers. Marime Gjata is one of them; for Marime **"working with technology is fun, is such a cool thing to be able to play with the latest products and know about the new ones that will soon enter the market".**




As the relationship between people and technology grows, the Kadiu brothers see their shop oriented more into a

faqeje interneti, në mënyrë që të përhapin në mbarë vendin lajmin rreth dyqanit dhe shërbimeve që ofrojnë, për tu bërë në një farë mënyre "vendi i duhur" për të blerë një paisje personale të teknologjisë së fundit. Dhe, nëse gjërat shkojnë ashtu siç duhet, ata parashikojnë dhjetë ose ndoshta njëmbëdhjetë të punësuar në biznesin e tyre brenda dy viteve të ardhshme.

problem-solving service between users and devices. They are working on developing an app and a website, in order to announce their shop-services to anyone in Albania, trying to become "the place-to-go" for a personal tech-device. And if things go as planned, they foresee ten or maybe eleven employees working for them within the next two years.

RisiAlbania po prezanton një kulturë të re në media, duke sjellë shpërndarjen e informacionit për tregun e punës në fokusin e medias. Projekti ka mbështetur mediat për të krijuar programe mbi tregun e punës, që janë tërheqëse sidomos për rininë; duke rritur, në njërën anë, audiencën e të ardhurat e tyre, dhe duke ndihmuar, në anën tjetër, të rinjtë për vendimmarrjen e duhur në lidhje me shkollimin, punësimin dhe karrierën. Rubrika e përjavshme radiofonike "Të reja mbi punësimin" në Club FM filloi në nëntor 2014, dhe pati një rritje audience prej 56% brenda sezonit të parë. Gjithashtu, RisiAlbania ka mbështetur edhe mediat e tjera për zhvillimin e materialeve të tyre për tregun e punës, si për shembull "Ti mundesh" një emision i përmuajshëm në Top Channel dhe suplementin javor "Drejt Punës" në gazetën Shqiptarja.com.

RisiAlbania is introducing a new media culture, bringing the dissemination of labor market information in the focus of the media. The project supports media organizations to create products that are attractive to young people in connection with the labor market, thus in one hand increasing their audience and profit, and on the other helping the youth to take informed decisions on education, career choices and employment opportunities. The "Employment News" weekly broadcast on Radio Club FM started in November 2014 and saw an audience increase of 56% within the first season. Moreover, RisiAlbania is supporting other media to develop their labor market content, such as the "You can do it!" monthly-show on Top Channel TV and "Towards Work" weekly-supplement in Shqiptarja.com.

